



SHERBIMI SOCIAL

#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Në 31 Maj në ditën Botërore kundër Duhanit, në institucionet e përkujdesit shoqëror është realizuar aktivitet ndërgjegjësues me përfituesit lidhur me rrezikun që sjell konsumimi i duhanit në sëmundjet e ndryshme.

Përfituesit e institucioneve u angazhuan në aktivitete me karakter informjues, sensibilizues dhe krijues.

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK

Gjatë muajve Prill-Maj 2023 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Ka përfunduar vendimmarrja për 12 Drejtoritë Rajonale.

Është realizuar kontroll në DRSSSH Shkodër, është përgatitur projekt- raporti përfundimtar për Drejtorinë Rajonale Shkodër dhe Tiranë.





SHERBIMI SOCIAL

Buletini Informativ

Prill - Maj 2023

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Gjatë muajve Prill-Maj 2023 Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 5 raste viktime trafikimi dhe 3 raste dhune.

Janë mbledhur komisionet e sistemimeve në institucion, nga të cilat janë sistemuar në institucion 4 fëmijë, 1 I moshuar, 1 fëmijë me aftësi ndryshe.

Janë rinovuar 28 librezat për Statusin e Jetimit.

